



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR EKONOMI DHE ZHVILLIM

Datë:	05.12.2024
Referenca:	
Për :	z. Imri Ahmeti - Kryetar i Komunës së Lipjanit
Kopje :	z. Diamant Bytyqi - Nënkyetar i Komunës z. Lulzim Qerimi – Nënkyetar për Komunitete
Nga:	z. Valon Pacolli - Drejtor i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim
Lënda:	Raport për muajin Nëntor - 2024

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë këtij muaji në Drejtoratin për Ekonomi dhe Zhvillim janë realizuar detyra dhe obligime, si dhe aktivitete që dalin nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, ligjet tjera sektoriale, udhëzimet, urdhëresat, statuti dhe rregulloret tjera komunale si dhe obligime të tjera nga e drejta pozitive në përgjithësi.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

- Finalizimi i punëve dhe implementimit të memorandumit në mes KEDS dhe Komunës së Lipjanit për furnizim me energji elektrike ZE Qylagë
- Mbajtja e diskutimit final me ekzekutivin për finalizimin e SZHE 2024-2029
- Mbajtja e takimit të radhës të këshillit publiko-privat si dhe formalizimi i këtij këshilli
- Bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë për fushën e sfidave të bizneseve lipjanase
- Takime me SDC dhe përfaqësuesit e Swiss Contact
- Angazhim në avansimin e kritereve të projektit BFC
- Pjesëmarrës në punëtorinë e organizuar nga CNVP me temën e prodhimit industrial nëpërmjet biomasesë

- Zhvillim i takimeve të punës me institutin KLGJ për temat “Planifikimi strategjik, zhvillimin e projekteve dhe menaxhimin e kontratave në komuna si dhe bashkëpunimi me kompanitë regjionale”
- Takime pune me Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe drejtorët e zhvillimit ekonomik lidhur me temën për zhvillimin e turizmit dhe projekteve turistike me mbështetje nga organizata zvicerane Swiss Contact
- Takime të ndryshme dhe sqarime të procedurave dhe mundësive që ofron niveli ynë lokal për investitorët potencial
- Përgatitje e faturave për shfrytëzuesit e pronës afatshkurtër komunale
- Përgatitje e raporteve mujore për ngarkesat e shfrytëzuesve afatshkurtër të pronave komunale, raporte këto të adresuara Sektorit-Pronësoro Juridik

STATISTIKAT

KRYERJA E PUNËVE PËR TË CILAT UDHËHIQET PROCEDURË ADMINISTRATIVE PËR PERIUDHËN 01.11.2024 – 30.11.2024

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA	SHËNIM
1	Pagesa të bizneseve për ndryshime	35	
2	Biznese të reja të regjistruara	33	
3	Duplikat dhe ndrrim të qertifikatave	8	
4	Kërkesë për ndryshim të adresës	2	
5	Ndryshim të njësisë	0	
6	Vërtetim që posedon apo nuk posedon biznes	0	
7	Shuarje të biznesit	4	
8	Shtim i aktivitetit të biznesit	1	
9	Informata të bizneseve	19	
10	Ndrrim i pronarit	2	
11	Kërkesë për ndryshim të emrit të biznesit dhe emrit tregtar	0	
12	Kërkesë për ndryshim të kapitalit	1	
13	Ndrrim të tipit të biznesit	1	
14	Ndrrim të drejtorit	1	
15	Shtim emaili dhe nr.tel.	0	